FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 90	2002	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8986 datë 23.12.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Palës Gjermane, të shtesës së projektit "Ujësjellës - kanalizimet e Korçës""……..	2641
Ligj nr. 8987 datë 24.12.2002	Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike…..……	2645
Ligj nr. 8988 datë 24.12.2002	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit"……..	2646

L I G J
Nr. 8986, datë 23.12.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PALËS GJERMANE, TË SHTESËS SË PROJEKTIT "UJËSJELLËS-KANALIZIMET E KORÇËS""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe palës gjermane, të shtesës së projektit "Ujësjellës-kanalizimet e Korçës"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3663, datë 14.1.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu.

MARRËVESHJE
PLOTËSUESE PËR FINANCIM E MARRËVESHJES PËR HUA, FINANCIM DHE PROJEKTIT TË DATËS 16 MAJ, 1997 SI DHE MARRËVESHJES SHTESË FINANCIARE DATË 22 MARS 2000 NDËRMJET KREDITANSTALT FUR WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË SI DHE NDËRMARRJA E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE KORÇË (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT) PËR KONTRIBUT FINANCIAR PREJ EURO 6. 646.794, 46 (SHTESË HUAJE)

Në bazë të një Marrëveshjeje që pret për t'u rakorduar ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për Bashkëpunim Financiar (Marrëveshje Qeveritare), përfituesi dhe KfW-ja lidhin këtë Marrëveshje Plotësuese për Financim Huaje.

Neni 1
Modifikime të Marrëveshjes për Financimin

Dispozitat e mëposhtme të Marrëveshjes për Hua, Financim dhe Projekte të datës 16 maj, 1997 si dhe Marrëveshjes Shtesë Financiare datë 22 mars 2000 do të modifikohen si vijon.

Neni 1.1
KfW do t'i akordojë Huamarrësit një Hua jo më të madhe se:
9. 970. 191, 69 euro

dhe
Kontribute financiare jo më të mëdha se:
14. 571. 818, 61 euro (investime)
dhe 255. 645. 94 euro (masa shoqëruese)
Kontributet Financiare nuk do të jenë të ripagueshme nëqoftëse nuk stipulohet ndryshe në nenin 5.3

b) Neni 3.2
KfW ka të drejtën të refuzojë kryerjen e zhbursimeve pas 30 dhjetorit, 2004.
c) Neni 4.4
Huamarrësi do të shlyej Huanë si më poshtë:

Këstet	Data	Shuma
1	30 dhjetor 2007 euro	55.219.52
2	30 qershor 2008 euro	55.219.52
3	30 dhjetor 2008 euro	55.219.52
4	30 qershor 2009 euro	55.219.52
5	30 dhjetor 2009 euro	55.219.52
6	30 qershor 20010 euro	55.219.52
7	30 dhjetor 2010 euro	55.219.52
8	30 qershor 2011 euro	55.219.52
9	30 dhjetor 2011 euro	55.219.52
10	30 qershor 2012 euro	55.219.52
11	30 dhjetor 2012 euro	163.219.52
12	30 qershor 2013 euro	163.219.52
13	30 dhjetor 2013 euro	163.219.52
14	30 qershor 2014 euro	164.219.52
15	30 dhjetor 2014 euro	164.219.52
16	30 qershor 2015 euro	164.219.52
17	30 dhjetor 2015 euro	164.219.52
18	30 qershor 2016 euro	164.219.52
19	30 dhjetor 2016 euro	164.219.52
20	30 qershor 2017 euro	164.219.52
21	30 dhjetor 2017 euro	164.219.52
22	30 qershor 2018 euro	164.219.52
23	30 dhjetor 2018 euro	164.219.52
24	30 qershor 2019 euro	164.219.52
25	30 dhjetor 2019 euro	164.219.52
26	30 qershor 2020 euro	164.219.52
27	30 dhjetor 2020 euro	164.219.52
28	30 qershor 2021 euro	164.219.52
29	30 dhjetor 2021 euro	164.219.52
30	30 qershor 2022 euro	164.219.52
31	30 dhjetor 2022 euro	164.219.52
32	30 qershor 2023 euro	164.219.52
33	30 dhjetor 2023 euro	164.219.52
34	30 qershor 2024 euro	164.219.52
35	30 dhjetor 2024 euro	164.219.52
36	30 qershor 2025 euro	164.219.52
37	30 dhjetor 2025 euro	164.219.52
38	30 qershor 2026 euro	164.219.52
39	30 dhjetor 2026 euro	164.219.52
40	30 qershor 2027 euro	164.219.52
41	30 dhjetor 2027 euro	164.219.52
42	30 qershor 2028 euro	164.219.52
43	30 dhjetor 2028 euro	164.219.52
44	30 qershor 2029 euro	164.219.52
45	30 dhjetor 2029 euro	164.219.52
46	30 qershor 2030 euro	164.219.52

2642

47	30 dhjetor 2030 euro	164.219.52
48	30 qershor 2031 euro	164.219.52
49	30 dhjetor 2031 euro	164.219.52
50	30 qershor 2032 euro	164.219.52
51	30 dhjetor 2032 euro	164.219.52
52	30 qershor 2033 euro	164.219.52
53	30 dhjetor 2033 euro	164.219.52
54	30 qershor 2034 euro	164.219.52
55	30 dhjetor 2034 euro	164.219.52
56	30 qershor 2035 euro	166.264.69
57	30 dhjetor 2035 euro	166.264.69
58	30 qershor 2036 euro	166.264.69
59	30 dhjetor 2036 euro	166.264.69
60	30 qershor 2037 euro	166.264.87
61	30 dhjetor 2037 euro	109.000.00
62	30 qershor 2038 euro	109.000.00
63	30 dhjetor 2038 euro	109.000.00
64	30 qershor 2039 euro	109.000.00
65	30 dhjetor 2039 euro	109.000.00
66	30 qershor 2040 euro	109.000.00
67	30 dhjetor 2040 euro	109.000.00
68	30 qershor 2041 euro	109.000.00
69	30 dhjetor 2041 euro	109.000.00
70	30 qershor 2042 euro	109.000.00
71	30 dhjetor 2042 euro	109.794.46
	Total euro	9.970.191.69

d) neni 4.9

Huamarrësi do të kryejë të gjitha pagesat në euro në llogarinë e KfW nr. 22.0256.0801 pranë Kreditansalt fur Wiederaufbau, Franfkurt am Main (BLZ 500 204 00 SWIFT: KFWIDEFF), nuk pranohen shtyrje dhe kundër pretendime në lidhje me pagesat.

1.2 Vazhdimi i të qenit në fuqi të Marrëveshjes për Financim

Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes për Hua, Financim dhe Projekte të datës 16 maj, 1997 si dhe të Marrëveshjes Shtesë Financiare datë 22 mars 2000 qëndrojnë të pandryshuara.

Seksioni 2

Dispozita plotësuese, për hyrjen në fuqi dhe marrjen fund të kësaj Marrëveshjeje

2.1 Interesi i shlyerjes për këtë Shtesë Huaje prej 6.646.794.46 euro do të fillojë të llogaritet tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje si dhe datave të fundit në të cilat do të debitohen disbursimet.

2.2 Gjatë periudhës deri në kryerjen e disbursimit të parë të shumës së Huasë, Huamarrësi duhet të paraqesë dëshmi të mjaftueshme pranë KfW-së që ka plotësuar të gjitha detyrimet e saj kushtetuese dhe ligjore duke marrë përsipër detyrimet që lindin sipas kësaj Marrëveshje Huaje.

2.3 Huamarrësi do të sigurojë që individët e caktuar nga ai për të përgatitur dhe vënë në zbatim kontributin financiar, dhënien e kontratës së shërbimeve dhe furnizimeve si dhe për zhbursimet e shumave nga Huaja nuk do të kërkojnë apo japin premtime për pagesa të paligjshme apo avantazhe të tjera në lidhje me këto punë.

2.4 Kjo Marrëveshje Plotësuese për Financim nuk do të hyjë në fuqi pa hyrë në fuqi Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën ajo mbështetet.

Kryer në 6 kopje origjinal, 3 në gjermanisht dhe 3 në anglisht.

Tiranë më 9.10.2002

Frankfurt am Main
KfW

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Përfaqësuar nga MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTËR I FINANCAVE

Kastriot Islami

L I G J
Nr. 8987, datë 24.12.2002

PËR KRIJIMIN E KUSHTEVE LEHTËSUESE PËR NDËRTIMIN E BURIMEVE TË REJA TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve lehtësuese, deri në liberalizimin e plotë të çmimit të energjisë elektrike, për çdo person juridik vendas dhe të huaj, që do të ndërtojë burime të prodhimit të energjisë elektrike.

Neni 2

Çdo person juridik vendas dhe i huaj, që do të ndërtojë burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, që përdorin lëndë djegëse të lëngëta ose të ngurta dhe pa kufizim për burimet e tjera të rinovueshme të prodhimit, përjashtohet nga taksat doganore për makineritë dhe pajisjet, që bëjnë pjesë në objektin e prodhimit të energjisë elektrike.

Neni 3

Çdo personi juridik vendas dhe i huaj, që ndërton burime të prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të nenit 2 të këtij ligji, i rimbursohet kundërvlefta e paguar për taksat doganore dhe akcizat e lëndëve djegëse të lëngëta ose të ngurta të përdorura për sasinë e energjisë së shitur, duke marrë në konsideratë konsumin specifik të teknologjisë së zbatuar.

Rimbursimi i taksës doganore dhe akcizëz së lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike, bëhet çdo 45 ditë.

Neni 4

Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike miraton marrëveshjen e shitjes së energjisë elektrike ndërmjet përsonave juridikë vendas dhe të huaj, që do të stimulohen për prodhimin e energjisë elektrike, sipas këtij ligji, me Kompaninë Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) ose konsumatorët e kualifikuar.

Neni 5

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e neneve 2 dhe 3 të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3664, datë 14.1. 2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu.**

L I G J
Nr. 8988, datë 24.12.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8550, DATË 18.11.1999
"STATUSI I DEPUTETIT"**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"1. Deputeti që nuk banon në qytetin e Tiranës përfiton dieta gjatë kohës që merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit, të komisioneve e mbledhjet e grupit parlamentar, ndërsa deputetët që banojnë në Tiranë përfitojnë dieta për ditët e shërbimit jashtë Tiranës. Modalitetet e përfitimit të dietave rregullohen me vendim të Kuvendit.

2. Dieta e Kryetarit, zëvendëskryetarëve dhe deputetëve do të jetë në masën 4 për qind të pagës mujore të tyre.

3. Deputeti që shkon me shërbim jashtë shtetit nga Kuvendi përfiton dietë ditore, sipas akteve të miratuara nga Kuvendi. Në rastet kur ai caktohet të marrë pjesë në delegacionet qeveritare ose të institucioneve të tjera, shpenzimet mbulohen nga institucioni që e ka ftuar, duke përfituar dietën sipas akteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

4. Deputeti ka të drejtë të pajiset me automjete nga Kuvendi. Shpenzimet për transport (shofer, karburant, shërbime teknike) përballohen nga Kuvendi, sipas kuotave të përcaktuara në vendimin e Kuvendit.".

Neni 2

Neni 18 pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Fondet për nevojat e mësipërme përballohen nga buxheti i Kuvendit.".

Neni 3

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

"Deputeti pajiset me shërbim telefonik. Vlefta e shpenzimeve për shërbimet e telekomunikacionit përcaktohet me vendim të Kuvendit.

Shpenzimet e mësipërme për kryetarët e grupeve parlamentare dhe të komisioneve të përhershme parlamentare janë 20 për qind më të larta se ato të deputetit.”.

Neni 4

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

"Institucionet e administratës publike, në të cilat deputetët kanë qenë të punësuar, pas mbarimit të mandatit të deputetit dhe nëse nuk kanë arritur moshën e pensionit, janë të detyruar ta rikthejnë atë në vendin e mëparshëm të punës ose t’i ofrojnë, brenda një viti nga koha e mbarimit të mandatit, një vend tjetër pune të ngjashëm ose të përafërt me atë të mëparshmin.".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3665, datë 14.1.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

Kodi Penal

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Mars, 2002

Kodi i Procedurës Penale

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Shtator, 2002

Kodi i Procedurës Civile

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Korrik, 2002

Kodi Rrugor

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Qershor,2002

Kodi Penal Ushtarak

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Tetor, 2002

Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Tetor, 2002

U dorëzua për shtyp më 21. 1. 2003
Doli nga shtypi më 21. 1. 2003

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 100 lekë